



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA TIRANË
QENDRA KOMUNITARE MULTIDISCIPLINARE

Nr. prot. _____

Tiranë , 14.05.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE TË VECANTA PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Furgon elektrik ”.

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):__ 34136000-9

Fondi limit: 4.000.000 (kater milion leke) leke, me tvsh zero .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Qendra Komunitare Multidisiplinare ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pagtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë bazuar në nenet 77, 82 të LPP, dhe nenin 40, 25, 26, 29 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Të gjitha këto kritere janë të nevojshme që të vërtetojnë që operatori ekonomik fitues përmbush të gjitha detyrimet ligjore për ushtrimin e veprimtarisë dhe ka përgjegjësinë e seriozitetit për realizimin e objektit të prokurimit.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1. Licencë e kategorisë VII.3.B.1 “Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove”, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) për të ushtruar veprimtarinë e shitblerjes së mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove, të reja ose të përdorura (pika d) dhe të shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimit lidhur me këto automjete, ose licencë ekuivalente sipas legjislacionit në fuqi të vendit ku operatori ekonomik ofertues ka selinë, në rastin e operatorëve ekonomike të huaj.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në Ligjin nr. 9573, datë 03.07.2006 “Për autoriparimin, shitblerjen, depozitimin e mjeteve rrugore me motor, të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtaritë që lidhen me to” (i ndryshuar), VKM Nr. 538 dt 26.05.2009 për “Licencat edhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL dhe disa rregullimi të tjera nënligjore të përbashkëta” (e ndryshuar), VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar) neni 40 pika 5/a, i cili përcakton se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose.....].

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kjo licensë është kërkuar duke marrë shkas nga lloji i mallit që do të prokurohet nga AK dhe është në përputhje dhe proporcion me nevojat dhe me qëllimin final të kësaj kontrate. Kjo licensë vërteton ekzistencën dhe përshtatshmërinë e OE lidhur me tregtimin/ shitjen e mjeteve me motor dhe rimorkiove dhe ofrimin shërbime të mirëmbajtjes.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse

operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 1,2/c dhe 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar. Referuar në nenin 29, të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit.**

- a. Kur shërbimet e mëparshme të ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vertetojë këtë duke paraqitur Kontraten e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni Shtetëror, për realizimin e plotë dhe të sukseshëm të kësaj kontrate.
- b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit objekt prokurimi. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallit që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog në gjuhën shqipe ose angleze (per operatoret e huaj), ku të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike, për të gjetur pasqyrim parametrat teknikë të produktit (shih specifikimet teknike) të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe të ofruara nga operatori ekonomik. Në katalogë, duhet të markohet me ngjyrë të qartë specifikimet teknike të kërkuara.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 6/b e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë që malli që ata disponojnë dhe tregtojnë është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mjetet e ofruara nga operatori ekonomik.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë ambient/servis për realizimin e shërbimeve profilaktike që do të kryhen periodikisht brenda periudhës së garancisë referuar zërave të preventivit. Po ashtu do të kryhet dhe riparimi dhe zëvendësimit i pjesëve të tjera (që nuk

përfshihen në shërbimet profilaktike) pa pagesë në rast konstatimi të ndonjë defekti të mundshëm. Lidhur me këtë kriter:

a. Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi një ambient pune (servis/oficinë) të përshtatshme për kryerjen e shërbimeve sipas specifikimeve teknike në funksion të realizimit të kontratës, i përshtatshëm për ushtrim aktiviteti sipas objektit të prokurimit i cili duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

Operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton pronësinë/huapërdorjen/qiramarrjen si më poshtë:

1. Dokumentacion që vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
- kontrata e shitblerjes; ose
- kontrata e dhurimit; ose
- çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

2. Dokumentacion që vërteton huapërdorjen:

- Kontratë huapërdorje.

3. Dokumentacion që vërteton marrjen me qira:

- Kontratë qiraje.

Shënim: Në rast se operatori ekonomik pjesëmarrës do të shpallet fitues, *përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*, ka detyrimin të paraqesë dokumentacionin provues si me lart.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në bazë të nenit 77, Kreu XII të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), pikës 8, nenit 40, Kreu V të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Shërbimet e mirëmbajtjes së shërbimeve profilaktike dhe të riparimit apo zëvendësimit të pjesëve të tjera (që nuk përfshihen në shërbimet profilaktike) pa pagesë në rast konstatimi të ndonjë defekti të mundshëm të automjeteve duhet të kryhen në ambiente të përshtatshme, servis ose oficinë i pajisur me të gjitha mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës. Në mënyrë që të vërtetohet që operatorët ekonomikë disponojnë hapësirën e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së tyre gjykojmë se është e nevojshme dokumentimi i këtij fakti përmes paraqitjes së një dokumenti i cili vërteton pronësinë, huapërdorjen, qiramarrjen referuar dispozitave përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesw një deklaratë ku deklaroon se në ambientet e servisit ku ushtron aktivitetin disponon pajisjet e nevojshme për realizimin e kontratës .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në bazë të nenit 77, Kreu XII të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) , pikës 6, nenit 41, Kreu V të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Shërbimet profilaktike të mirëmbajtjes dhe të riparimit ose zëvendësimit të pjesëve të tjera (që nuk janë shërbime profilaktike) në rast defekti duhet të kryhen në ambiente të përshtatshme, servis ose oficinë i pajisur me të gjitha mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e kontratës. Për këtë mjafton vetëm një deklaratë nga ana e operatorit ekonomik që servisi/oficina që ai disponon është në përputhje me kërkesat e Autoriteti Kontraktor. Percaktimi i repartit të mësipërm është bërë referuar zërave të preventivit për këtë objekt prokurimi. Gjithashtu, Autoriteti Kontraktor, rezervon të drejtën të inspektojë në vend ambientet e sipërpërmendura, me qëllim verifikimin e kërkesave të sipërcituara .

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë:

- a) që garanton mbulimin e periudhës së garancisë së mjetit, për një periudhë jo më pak se 5 vjet ;
- b) ku garanton kryerjen e shërbimeve për riparimin e automjeteve (që nuk përshihen në shërbimet profilaktike) pa pagesë , gjate periudhës së garancisë;
- c) ku te specifikojë cilat nga pjeset teknike te automjetit jane brenda garancise.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të gjitha riparimet dhe shërbimet e përcaktuara në deklaratë do të kryhen te operatori ekonomik kontraktues pa pagesë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim

